



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 775/3 Prot.

Tiranë, më 14.12.2020

**V E N D I M**

Nr.177, datë 14.12.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 30969, datë 17.12.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 775 prot., datë 7.10.2020, nëpunësi doganor \*\*\*\*\*, ka parashtruar pretendimin se transferimi i tij i përkohshëm në pozicionin “Doganier, Zyra e Kontrolleve Doganore”, Sektori i Mbikëqyrjes Doganore, Dega Doganore Fier, është bërë në shkelje të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil që rregullojnë transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar që: Në kuadër të implementimit të strukturës së fundit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, njësia përgjegjëse (DAP), pasi ka shqyrtuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, ndërmjet të tjerave, me aktin nr. 561/36, datë 26.1.2018, ka miratuar transferimin e përhershëm të nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe

mbi këtë bazë, ka dalë akti nr. 2197 prot., datë 26.1.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm.

Për të gjitha veprimet e kryera në këtë rast, janë mbajtur parasysht rregullat për rastet e ristrukturimit, që parashikon ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe dispozitat e legjislacionit doganor (*pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar*), ku parashikohet shprehimisht që në administrimin e shërbimit doganor, krahas dispozitave të posaçme të Kodit Doganor zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil.

Pasi ka marrë emërimin në pozicionin *“Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër”*, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, ai ka punuar një periudhë kohe në atë pozicion, deri në daljen e aktit nr.30969 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, me të cilin për interes të institucionit, punonjësi \*\*\*\*\*, është transferuar përkohësisht, në pozicionin *“Doganier, Zyra e Kontrollleve Doganore”*, Sektori i Mbikëqyrjes Doganore, Dega Doganore Fier, (*ku vazhdon të punojë, aktualisht*).

Meqenëse ka patur pretendime për ligjshmërinë e këtij akti, punonjësi në fjalë, vetëm pasi ka përfunduar afati 6-mujor, si afat maksimal që përcakton ligji në rastin e transferimeve të përkohshme, e ka kundërshtuar atë pranë titullarit të institucionit, Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe pranë Departamentit të Administratës Publike, si njësi përgjegjëse, duke kërkuar dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës si *“Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër”*, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (*kërkesa nr. 11659 prot., dt. 24.6.2020*).

Pas shqyrtimit të kërkesës së mësipërme, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e institucionit, me shkresën nr. 11659/1 prot., datë 30.6.2020, i ka kthyer përgjigje kërkuarit, por nuk ka kryer veprimet e nevojshme për kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

Në kushtet kur nuk pati një reagim të mëtejshëm nga ana e institucionit, punonjësi në fjalë ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, për tu kthyer në vendin e punës si *“Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër”*, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku ai ka emërimin e përhershëm, meqë afati i transferimit të përkohshëm ishte tejkaluar.

Në kuadër të vlerësimit të veprimeve dhe akteve administrative si më sipër, konstatohet se për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (*pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor*), janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” parashikon: *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i. në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii. për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës”.*

Siç shihet, në shkronjën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit nr. 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, sipas së cilës lejohet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (*njëherësh ose i copëzuar*) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve.

Kjo do të thotë që ndryshe nga një nëpunës civil i zakonshëm, një nëpunës doganor mund të transferohet përkohësisht për nevoja të institucionit, sa herë lind nevoja për diçka të tillë, pa patur ndonjë kufizim ligjor në shpeshtësi, prandaj në këtë vështrim nuk mund të pranohet pretendimi se, transferimi i përkohshëm është i padrejtë për shkak se kërkuesi ka emërim definitiv pas ristrukturimit të institucionit.

Fakti që në përmbajtjen e aktit nr. 30969 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nuk është përcaktuar afati i transferimit të përkohshëm, nuk e bën aktin të paligjshëm. Përderisa jemi para një transferimi të përkohshëm, për nevoja të institucionit (*pika “i”, e dispozitës së sipërcituar*) dhe meqë dispozita referuese e aktit e parashikon në mënyrë të shprehur afatin maksimal të transferimit të përkohshëm, kohëzgjatja pavarësisht se nuk është shënuar në akt, prezumohet se nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

Gjithashtu konstatohet që, akti është i ligjshëm, pasi është nxjerrë nga organi kompetent, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, siç parashikon pika 17, kreu V, *“Transferimi i përkohshëm”*, e vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për personelin e administratës doganore”*, i ndryshuar duke u ruajtur edhe kategoria e pagës që ka patur në pozicionin e mëparshëm, (*kategoria e pozicionit C2, kategoria e pagës IV-a*).

Më tej, po në këtë pikë, parashikohet se, në rastin e punonjësve doganorë që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, një kopje e aktit të transferimit i dërgohet për dijeni Departamentit të Administratës Publike, i cili megjithëse është njësi përgjegjëse për institucionin, në këtë rast, nuk luan rolin e organit miratues, sikurse parashikohet në pikën 5, kreu I, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*. Sipas kësaj pike të aktit të mësipërm nënligjor, organi i vetëm që urdhëron transferimin e përkohshëm të punonjësve doganorë dhe në shumicën e rasteve edhe nisjen e

procedurës me kërkesën e tij, është Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Në këto kushte, pretendimi se akti i transferimit të përkohshëm është i paligjshëm, pasi nuk është miratuar nga Departamenti i Administratës Publike, është i pabazuar në ligj.

Nga analiza e gjithë sa u përshkrua më sipër, arrihet në përfundimin se, transferimi i përkohshëm i punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Doganier, Zyra e Kontrolleve Doganore*”, Sektori i Mbikëqyrjes Doganore, Dega Doganore Fier, është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor.

Por, nga ana tjetër është me vend të nënvizohet që, nga ana e organit kompetent që urdhëron këto lloj transferimesh dhe njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, është vepruar në shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, në momentin që nuk është respektuar urdhërimi i ligjit, në shkronjën “c”, pika 7, të nenit 15, të Kodit Doganor, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur: “*Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar*”.

Në kushtet kur vërtetohet që afati 6-mujor i transferimit të përkohshëm, të nëpunësit \*\*\*\*\* ka përfunduar (në *Qershor 2020*), si dhe kur nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor të parashikuar në ligj, ky punonjës duhej të ishte rikthyer në vendin e mëparshëm të punës.

Në të njëjtën kohë, do të ishte e drejtë që pas kësaj të mbahet parasysh që, nëpunësi doganor mund të transferohet për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së objektive dhe të argumentuar, duke përcaktuar saktë afatet dhe duke mbajtur parasysh parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar, përkatësisht, në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “*Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër*”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati

maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe mungon pëlqimi i nëpunësit për të vazhduar në atë pozicion pune.

2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ka detyrimin të krijojë kushtet e nevojshme dhe të ndjekë procesin e zbatimit të këtij vendimi.
3. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**